

RAPORT INDIVIDUAL I KONSULTIMIT PUBLIK

1. Titulli i draft aktit/dokumentit

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Kohëzgjatja e konsultimeve për projektaktin ka qenë 30 ditë pune. Në datë 12 Shtator 2022 është publikuar në regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike (në nivel eksperti dhe qytetari), deri në datë 12 Tetor 2022 si dhe mbas reflektimit të komenteve në periudhën 13-26 Dhjetor 2022.

<http://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/515> ; <http://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/514>

Gjithashtu dhe në website zyrtare të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë: [https://www.infrastruktura.gov.al/konsultime-publike/dhe AMA](https://www.infrastruktura.gov.al/konsultime-publike/dhe-AMA).

Në regjistrin e konsultimeve publike ka pasur 531 lexime nga qytetarët dhe 392 lexime nga ekspertët, dhe ka patur 2 komente/sugjerime nga Rrjeti Fuqizimit Gruas në Shqipëri dhe Organizata “AWA Albanian Woman in Audiovisual” në fazën e parë të konsultimit.

Ndërsa në adresën elektronike ka pasur 1 (një) koment nga Dhoma Amerikane e Tregtisë dhe 1 (një) koment nga Organizata “AWA Albanian Woman in Audiovisual”(e njëjtë me atë në RENJK). Pranë AMA kanë paraqitur komente, sugjerime tre operatorë të medias audiovizive.

3. Metoda e konsultimit

Është zhvilluar procesi i konsultimit publik nëpërmjet:

1. Publikimit të projektaktit më datë 12 Shtator 2022, në regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike (RENJK);
2. Publikimi i projektaktit dhe relacionit mbas reflektimit të komenteve në RENJK nga data 13.12.2022 deri në 26.12.2022;

3. Publikimit të projektaktit dhe paketës shoqëruese, në website zyrtar të MIE, datë 12 Shtator 2022 dhe pika kontakti vilma.davidhi@infrastruktura.gov.al; fotjon.kosta@infrastruktura.gov.al;
4. Publikimi projektaktit dhe relacionit mbas reflektimit të komente në website zyrtare të MIE datë 13.12.2022 (të e njëjta datë e publikimit te mëparshëm 12.09.2022), dhe pika kontakti vilma.davidhi@infrastruktura.gov.al; fotjon.kosta@infrastruktura.gov.al;
5. Takime, diskutime konsultative me Institucionet si: Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme.
6. Takim teknik me përfaqësues të Komisionit European, DG Near dhe DG Connect, EUD dhe Observatorin e Medias Europiane me datë 8.11.2022;
7. Takim me përfaqësues të Organizatës “AWA Albanian Woman in Audiovisual” datë 26 Janar 2023, pranë ambienteve të MIE.

4. Palët e interesit të përfshira

Për procedim e hartimit të projektligjit është bashkëpunuar midis AMA dhe MIE. Gjithashtu është marrë asistencë teknike nga TAIEX dhe organizuar dy workshope me pjesëmarrje të AMA, Ministria e Kulturës, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, MIE, Kuvendi i Shqipërisë.

Palë të interesuara që kanë marrë pjesë në konsultim janë operatorët e medias audiovizive, institucionet publike si dhe Komisioni European.

1. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuar

Komentet dhe Propozimet e marra:

Nga aktorët e interesuar ka patur disa propozime/komente për draftin, specifike dhe të përgjithshme.

Çështjet e adresuara	Komentet	Palët e interesuara	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi

Seksizmi ne media	Janë dhënë disa komente e sugjerime për nenet 2, 4, 9, 32, 33, 46, 94 etj.	Sabina Kodra, AWA	I pranuar pjesërisht	Kthyer pergjigje përmes platformës dhe sqaruar: Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" , i ndryshuar, synon tranzpozimin e pjesshëm të Direktivës 2018/1808 (BE) dhe Direktivës 2018/1972/BE, në kuadër të angazhimeve dhe detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, neni 70 “Përafrimi i legjislacionit...” dhe neni 10.3 “Shoqëria e Informacionit”, harmonizimi i legjislacionit të fushës audiovizive me “acquis communautaire”, në të cilën përfshihet edhe Direktivën e sipërcituar. Pra, në këtë fazë, ndryshimet e ligjit 97/2013, i ndryshuar, vijnë si pasojë e procesit të përafrimit të legjislacionit vendas, me acquis communitarie të BE-së. Megjithatë, referuar sugjerimeve/komenteve tuaja, ju
-------------------	--	-------------------	----------------------	--

				bëjmë me dije se, Kodi i Transmetimit për median audiovizive miratuar me vendimin e AMA-s nr. 228, datë 11.12.2017, është në proces rishikimi. Drafti i këtij Kodi, përmban një seksion të veçantë, dedikuar promovimit të barazisë gjinore, parandalimin dhe luftimin e diskriminimit gjinor në mediat audiovizive. Në këto kushte kërkesat e parashtruara nga ana Juaj do të merren në shqyrtim gjatë procesit të rishikimit të Kodit të Transmetimit.
1. Në çështjet e barazisë gjinore	Dhënë disa komente e sugjerime. Në mënyrë të përmbledhur kërkohej përfshirja në projektligj të disa aspekteve të barazisë gjinore, konkretisht garantimin e barazisë gjinore dhe luftës kundër seksizmit në median audiovizive, garantimin e barazisë gjinore në zgjedhjen e anëtarëve të AMA-s si dhe të KDRTSH-s, etj.	RRJETI FUQIZIMIT GRUAS NE SHQIPERI	I pranuar pjesërisht	Kthyer përgjigje përmes platformës dhe sqaruar: Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" , i ndryshuar, synon tranzpozimin e pjesshëm të Direktivës 2018/1808 (BE) dhe Direktivës 2018/1972/BE, në kuadër të angazhimeve dhe detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, neni 70

				“Përafrimi i legjislacionit...” dhe neni 10.3 “Shoqëria e Informacionit”, harmonizimi i legjislacionit të fushës audiovizive me “acquis communautaire”, në të cilën përfshihet edhe Direktivën e sipërcituar. Pra, në këtë fazë, ndryshimet e ligjit 97/2013, i ndryshuar, vijnë si pasojë e procesit të përafrimit të legjislacionit vendas, me acquis communitarie të BE-së. Megjithatë, referuar sugjerimeve/komenteve tuaja, ju bëjmë me dije se, Kodi i Transmetimit për median audiovizive miratuar me vendimin e AMA-s nr. 228, datë 11.12.2017, është në proces rishikimi. Drafti i këtij Kodi, përmban një seksion të veçantë, dedikuar promovimit të barazisë gjinore, parandalimin dhe luftimin e diskriminimit gjinor në mediat audiovizive. Në këto kushte kërkesat e parashtruara nga ana Juaj do të merren në shqyrtim gjatë procesit të
--	--	--	--	--

				rishikimit të Kodit të Transmetimit.
3. Rregullat për ofrimin e shërbimeve mediatike audio dhe/ose audiovizive.	Kërkuar ndryshime në kreun IX të ligjit, i cili përcakton rregullat për ofrimin e shërbimeve mediatike audio dhe/ose audiovizive, sipas kërkeses së përdoruesit. Konkretisht , Dhoma sugjeron që pika 9 e nenit 75 të ligjit e cila citon se: "Pikat 1 deri në 8 të këtij neni zbatohen vetëm për ata OSHMA audiovizive që kryejne transmetime televizive" duhet të shfuqizohet.	Dhoma Amerikane e Tregtise		Kthyer përgjigje me e-mail. Duke sqaruar se kërkesat janë të lidhura me shumë me aktet nënligjore në zbatim të ligjit.

Ndërkohë janë marrë komente dhe sygjerime nga institucione shtetërore, nëpërmjet sistemit të e-Akteve, si dhe nga AMA dhe OSHMA, në menyrë shkresore, të cilat janë marrë pjesërisht në konsideratë.

Gjithashtu, projektligji u konsultua me Komisionin Evropian. Nga Komisioni European u kërkuar përfshirja e rregullimeve për platformat online sipas direktives 2018/1808/EU. Projektligji u rishkua duke reflektuar sugjerimet. Projektligji i rishikuar u ridergua ne Komisionin European. Me datë 21.12.2022 Komisioni European shprehet pozitivisht për draftin e rishikuar.

Pasi u bënë ndryshimet e sugjeruara nga BE në projektligj, ai u përcoll për komente në MD dhe aktorë të tjerë. Pritet mendimi i MD mbi versionin e rishikuar më pas, projektligji do të përcillet në Këshillin e Ministrave për të kaluar procedurën e miratimit.